



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-21-0178

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

M R Komuna Gjilan, i përfaqësuar nga avokati **Shabi Isufi**, rruga "Lidhja e Prizrenit" II/3, Gjilan.

kundër

E paditura

NSH, "SHANT Qarkullimi", Gjilan, (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-0600 të datës 26 shkurt 2021, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 13 janar 2022, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar .

2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-0600 i datës 26 shkurt 2021.

3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 22 prill 2013, paditësi e dorëzoi një ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI100-0016 të datës 19 mars 2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 06 qershor 2006 deri 28 mars 2007, në shumë prej 700,00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi ka pretenduar se Autoriteti i Likuidimit gabimisht ka konstatuar se kërkesa është parashkruar. Tutje ai pohon se me Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Gjilan C.nr.549/06 deri C.nr.570/06 dhe C.nr.757/06 të datës 19.01.2007, i është pranuar kërkesa për pagesën e pagave në shumë prej 2.148,82 euro për periudhën prej datës 01.01.2005 e deri me datën 06.09.2006, si dhe i është pranuar edhe shuma prej 437,00 euro në emër të kontributeve pensionale që duhet paguar trustit të kursimeve pensionale. Paditësi pohon se ky Aktgjykim është bërë i formës së prerë me 21.05.2007. Paditësi ka kërkuar që të anulohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 10 tetor 2016, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja po ashtu pohon se paditësi tek Autoriteti i Likuidimit i ka dorëzuar tre formular të kërkesave, me objekte, shumë dhe periudha të ndryshme, duke pohuar se i ka shqyrtuar të tri kërkesat veq e veq me tri vendime të veçanta. Tutje AKP-ja pohon se me vendimin GJI100-0018 i është pranuar në tërësi kërkesa për pagesën e pagave e cila bazohej në Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Gjilan C.nr.549/06 deri C.nr.570/06 dhe C.nr.757/06 të datës 19.01.2007. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa për pagesën e pagave në shumë prej 700 euro është refuzuar me vendimin GJI100-0016 të datës 19.03.2013, pasi që paditësi lidhur me këte

kërkesë nuk ka ofruar prova se e ka ndërprerë parashkrimin, e cila kërkesë i referohej periudhës 06.09.2006 deri me 28.03.2007, periudhë kjo e pa kërkuar, e pa mbuluar dhe e pa trajtuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan. Prandaj me të drejtë kërkesa nga ana e Autoritetit të Likuidimit është konsideruar si e parashkruar. Bashkë me përgjigje në ankesë AKP-ja e dorëzon vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI100-0018 të datës 07 maj 2013, me të cilën paditësit i është pranuar kërkesa e cila bazohej në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan.

Me datë 03 nëntor 2016, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe jep përgjigje në përgjigje në ankesë. Në këtë parashtresë paditësi prapë kundërshton qëndrimin e AKP-së se kërkesa është parashkruar. Në këtë parashtresë ai i përsërit të njëjtat pretendime të cekura edhe në ankesë.

Me datë 25 nëntor 2016, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundër përgjigjen, në të cilën ajo i përsërit pretendimet e veta të cekura në mbrojtjen në ankesë.

Me datë 26 shkurt 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-0600 e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësi në bazë të nenit 42 paragrafi 2 të LDHP dhe nenit 7 të LPK-së e kishte barrën e provës ai ka dështuar të dorëzoi në Gjykatë prova për të dëshmuar se këto paga i ka kërkuar më herët para datës 24 shkurt 2011, kur kërkesën e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit, andaj me të drejtë kërkesa është konsideruar si e parashkruar. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësi nuk mund ta përdor Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan si provë për të vërtetuar ndërprerjen e parashkrimit, duke konstatuar se me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.549/06 , C.nr.570/06 dhe C.nr/757/06, të datës 19 janar 2007, është aprovuar padia e paditësit dhe atij i është pranuar pagesa e pagave në shumë prej 2.148,82 euro për periudhën 01.01.2005 e deri me datë 06.09.2006, si dhe shumën prej 437,00 euro në emër të kontributeve pensionale, ndërsa Autoriteti i Likuidimit duke u bazuar në këtë Aktgjykim me vendimin

GJI100-0018 të datës 10 maj 2013, e ka pranuar shumën e njëjtë të kërkesës që ishte aprovuar edhe me Aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj Gjykate. Andaj ankesa e cila është paraqit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI100/0016 e datës 19 mars 2013, nuk mund të ndërlihet me kërkesën kreditore të iniciuar në Gjykatën Komunale në Gjilan dhe e përmbyllur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI100-0018, të datës 10 maj 2013. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësi e ka humbur afatin ligjor për të kërkuar pagat e pa paguara për periudhën 06 qershor 2006 deri me 28 mars 2007 në shumë prej 700,00 euro, e cila kërkesë me të drejtë për shkak të parashkrimit është refuzuar me vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI100-0016 të datës 19 mars 2013.

Me datë 17 mars 2021, paditësi ka parashtruar një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-13-0600, të datës 26 shkurt 2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të detyrohet e paditura ti paguaj paditësit në emër të pagave të pa paguara për periudhën 06 qershor 2006- 28 mars 2007, shumën prej 700 euro euro si dhe shpenzimet procedurale. Për më tepër në ankesë paditësi pretendon se Aktgjykimi i ankimuar bazohet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Tutje në ankesë pohon se pretendimet e AKP-së janë të pa baza dhe se antiligjore, ndërsa gjykimi bazohet gabimisht në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, kinse kërkesa është parashkruar. Tutje ai pohon se qështja e pagave është iniciuar pranë Gjykatës Komunale në Gjilan dhe kjo ka përfunduar me Aktgjykimin e plotfuqishëm C.nr.549/06 deri me C.nr.737/06 dhe ky Aktgjykim nga data 21.05.2007, i cili ka marrë formën e prerë. Në ankesë paditësi prapë i përsërit të njëjtat pretendime të cilat i kishte pohuar edhe në ankesën e Shkallës së I-rë duke pohuar se Aktgjykimi e ka ndërprerë parashkrimin edhe për pagat e periudhës vijuese për 7 pagat e pa paguara, andaj është i pa bazë pretendimi i Autoritetit të Likuidimit dhe i Gjykatës së kërkesa është parashkruar.

Me datë 12 gusht 2021, AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankuesit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se ajo e

mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit si të pabazuara. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë pohon se nuk do t'i përsërisë argumentet edhe më herët gjatë mbrojtjes në padi, pasi që kjo do të jetë e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Andaj nga këto arsye AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjorë, andaj duhet vërtetuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 24 shkurt 2021, e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit për pagesën e pagave të pa paguara nga NSH-ja për periudhën 06 qershor 2006 deri me 28 mars 2007, në shumë prej 700,00 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se është parashtruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë për të njëjtën bazë ligjor e refuzon ankesën dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.549/06 deri C.nr.570/06 dhe C.nr.757/06, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 21 maj 2007, paditësit M R i është njohur e drejta në paga në shumë prej 2.148,82 euro për periudhën kohore prej datës 01.01.2005 e deri me datën

06.09.2006, dhe po ashtu i është njohur edhe shuma prej 437,00 euro në emër të kontributeve pensionale që duhet paguar Trustit të kursimeve pensionale në Kosovë. Kjo shumë e aprovuar e pagave të pa paguara për periudhën e cekur, tashmë është pranuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit përmes vendimit GJI-100-0018, të datës 07 maj 2013, dhe këtë vendim siç u tha më sipër e ka ofruar AKP-ja me mbrojtjen në ankesë.

Paditësi kishte dorëzuar kërkesën tjetër për paga tek Autoriteti i Likuidimit me datë 24 shkurt 2011, për një periudhë tjetër dhe atë nga data 06 qershor 2006 - 28 mars 2007, e cila periudhë nuk është e mbuluar me Aktgjykimin e cekur të Gjykatës Komunale në Gjilan. Rrjedhimisht mund të konstatohet se kjo kërkesë e tij e re për paga, më parë nuk është iniciuar në Gjykatën Komunale në Gjilan, prandaj është i pa drejtë dhe i pa bazë ligjore pretendimi i paditësit se Aktgjykimi i cekur i Gjykatës Komunale në Gjilan e ka ndërprerë parashkrimin edhe për kërkesën për paga që i përket periudhës 06 qershor 2006 - 28 mars 2007, në shumë prej 700 euro.

Prandaj nga këto arsye është i drejtë dhe i bazuar në ligj konstatimi i Autoritetit të Likuidimit dhe i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa për këto paga të periudhës së cekur është parashkruar.

Prandaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar nuk mund të ndryshohet, andaj ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e

taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 13 janar 2022.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues
